



2020




 REPUBLIKA E KOSOVË
 KOMUNA RRAHOVEC
 KABINETI I Kryetarit

Nr. _____
 i ftoq/Br.shr/No.pg. 62
 Data/Datum/Date 05 / 05 / 2020
 RRAHOVEC / ORAHOVAC

Kryetari i Komunesë

BULETINI MUJOR KOMUNAL

KOMUNA RAHOVEC - PRILL 2020

Zyra e Kryetarit Adresa: Rr. 8 Dëshmorët e Pashtrikut p.n,21000,Rahovec –Kosovës Tel :0382004534

PËRMBAJTJA

HYRJE	2
AKTIVITETE TË KRYETARIT DHE DREJTORËVE TË DREJTORIVE	2
PËRFUNDIM	14

HYRJE

Ky organ botues është krijuar me idenë fillestare të promovimit të aktiviteteve të Kryetarit të Komunës dhe drejtorëve të drejtorive përgjatë muajve të vitit 2020, rëndësia e botimit të buletinit disa herë në vit qëndron në dhënien e mundësisë për informacionet mbi vendimet, zbatimin e politikave dhe rezultatet e aktiviteteve të Komunës së Rahovecit në mënyrë të tillë që të mundësojmë që qytetari të ndjekë dhe të kontribuojë në mënyrë efektive në punën e institucioneve lokale.

Edhe muaji prill i vitit 2020, është karakterizuar me një sërë aktiviteteve, pas shfaqjes së pandemisë COVID-19, situatë kjo e cila ka sjellur mjaft vështirësi edhe në Komunën e Rahovecit.

Me anë të këtij buletini mujor për muajin prill, ne jemi munduar të paraqesim me fotografi dhe në detaje masat e ndërmarra, veprimet konkrete nga ana e Kryetarit të Komunës së Rahovecit dhe Shtabit të Posaçëm Emergjent në Komunën e Rahovecit, shtab ky i themeluar për parandalimin e përhapjes së virusit korona.

Poashtu, përmes këtij buletini do paraqiten edhe aktivitete të ndryshme të Kryetarit të Komunës së Rahovecit, z.Smajl Latifi dhe drejtorëve të drejtorive në Komunën e Rahovecit.

AKTIVITETE TË KRYETARIT DHE DREJTORËVE TË DREJTORIVE



Kryetari, z.Smajl Latifi me bashkëpunëtorë , bashkëqytetarë dhe përfaqësues të OVL-së, kujtuan dëshmorët e kombit Nesimi Elshani dhe Habib Gashi, si dhe martirët në Nagac, gjaku i të cilëve është në themele të lirisë së Kosovës.

LAVDI!

Në Hoçë të Vogël, u kujtuan me përlujtje e nderim, 10 dëshmorët dhe qytetarët martirë të vrarë nga okupatori serb më 2 prill 1999.

LAVDI!





Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal ka publikuar rezultatet për arritjen e përgjithshme të performancës më të mirë komunale dhe sipas këtyre rezultateve të publikuara, nga 38 komunat e Republikës së Kosovës, Komuna e Rahovecit është përfituese e Grantit të Performancës Komunale në mesin e 23 komunave përfituese të Republikës së Kosovës.

Vlera totale e Grantit të fituar për performancë të mirë komunale është: 255.731 euro.



Kryetari, z. Smajl Latifi ka pritur në takim Ministren në detyrë të Administrimit të Pushtetit Lokal, znj. Emilija Rexhepi, dhe ud. Ministrin e Punëve të Brendshme z. Xhelal Sveçla, me të cilët bashkëbiseduan lidhur me gjendjen e krijuar pas përhapjes së virusit COVID-19 dhe masat mbrojtëse që janë ndërmarrë nga ana e komunës së Rahovecit për parandalimin e përhapjes së këtij virusi.

Ka përfunduar hapja dhe rregullimi i rrugës fushore që lidh fshatrat Drenoc dhe Nushpal, hapja e kësaj rruge përfshinë mbi 100 ha me vreshta dhe toka tjera të punueshme.



Rregullimi i rrugëve fushore ka rëndësi të madhe për fermerët e komunës sonë. Shumë toka të punueshme kishin qasje të vështirë për mungesë të rrugëve, ku si pasojë e kësaj për shumë vite kishin mbetur djerrinë. Aktualisht punimet janë duke u zhvilluar në: Dejnë, Dobidol, Vrajkë, Zoqisht dhe Hoçë të Vogël.





Pranvera për Pataqanin e Poshtëm do të jetë më e bukur këtë vit, me parkun në qendër të fshatit, punimet e të cilit do të përfundojnë së shpejti.

Mirëmbajtja e hapësirave publike në qytetin e Rahovecit. Kur të tjerët rekomandohen të qëndrojnë në shtëpi punëtorët e kompanisë Ekoregjioni janë në terren çdo ditë.



Vazhdojnë punimet në ndërtimin e rrjetëve të ri të kanalizimit në disa vendbanime: Fortesë, Krushë e Madhe, Opterushë dhe Dobidol. Do të vazhdojmë edhe në vendbanime tjera sipas projektit dhe kërkesave të qytetarëve!





Në Pataqan të Ulët, u kujtuan dëshmorët dhe martirët e rënë në luftë për lirinë e atdheut.

LAVDI!

Po vazhdojnë punimet për ndërtimin e objektit të çerdhes për fëmijë në fshatin Xërxë! Tani po bëhen përgatitjet për të mbushur me beton pllakën e katit të parë.



Kanë vazhduar edhe këto ditë pa u ndalur punimet në ndërtimin e objektit të shkollës "Liria" në Fortesë dhe objektit të Sallës së Edukatës Fizike.



Së shpejti do të fillojnë punimet në realizimin e projektit të efijencës së energjisë në objektin e Shfmu "Nesimi Elshani" në Nagac, ky është njëri prej 4 projekteve të kërkuara dhe të fituara që 2 vite nga komuna jonë për zbatimin e masave të efijencës së energjisë në objekte shkollore, i cili më në fund po fillon të bëhet realitet! Në kuadër të këtij projekti do të bëhet instalimi i ngrohjes qendrore, rregullimi i ndriçimit të brendshëm, ndërrimi dhe riparimi i dymve dhe dritareve dhe termoizolimi i kulmit.



Drejtori i DKA-së, z.Avni Morina vizitoi shkollën "Heronjtë e Kosovës" në Hoçë të Vogël/Brestoc, ku kanë filluar punimet në instalimin e sistemit të ngrohjes qendrore. Puna po zhvillohej në shtrirjen dhe montimin e gypave përcjellës të ngrohjes, për të vazhduar më tej me montimin e radiatorëve.



Në kujtim dhe nderim të sakrificës sublime për lirinë e atdheut, në 21 vjetorin e rënies në fushëbetejë të "Rrezet e Krushës", Kryetari Latifi me bashkëpunëtorë, përfaqësues të fshatit dhe përfaqësues të OVL-së, nderuan kujtimin për jetën, veprën dhe sakrificën e dëshmorëve Dalip Behra dhe Bekim Gashi, nga fshati Krushë e Madhe. LAVDI!



Kryetari, z.Smajl Latifi, ka mbajtur mbledhjen e Shtabit të Posaçëm Emergjent në komunën e Rahovecit ku pikë kryesore e këtij takimi ishte diskutimi për situatën aktuale në komunën e Rahovecit, si pasojë e përhapjes së pandemisë Covid 19 dhe masat të cilat është duke i marrë komuna e Rahovecit për parandalimin e kësaj pandemie.

Pas përpjekjeve të shumta të Kryetarit Latifi dhe adresimit serioz e me urgjencë të kërkesave, nevojave dhe shqetësimeve, të koordinimit me kryetarët e komunave përmes AKK-së, si dhe angazhimit të Ministrisë së Bujqësisë, karshi masave të reja për kufizimin e lëvizjes, masa këto të cilat pamundësonin qasjen e fermerëve tanë në tokat e tyre, fermerët e komunës së Rahovecit janë lejuar të përfundojnë punët e tyre pranverore, gjithmonë duke i'u përmbajtur rekomandimeve të profesionistëve shëndetësor.





Kryetari Latifi me bashkëpunëtorë, përfaqësues të OVL të UÇK-së, me familjarë e bashkëqytetarë, në Çifllak, në 21 vjetorin e rënies, kujtuan dëshmorin e rënë për liri, Halil Thačin. Njëherësh, kujtuan edhe (Veli Rr. Krasniqi, Mustafë I. Mazreku dhe Rexh S. Halilaj), tre qytetarët e vrarë nga forcat pushtuese serbe nga fshati Çifllak, si dhe kontributin e madh të të ndjerit Gani J. Thaçi

Kryetari z. Smajl Latifi së bashku me drejtorin e DBPZHR-së z. Berat Duraku dhe drejtorin e DEZHT-së, z. Artan Asllani, kanë vizituar fermerin blegtor Shefqet Sallahaj në fshatin Kaznik të komunës së Rahovecit, i cili në fermën e tij posedon mbi 500 krerë bagëti të imëta (dhive) si dhe 60 krerë lopë.



Homazhe dhe nderime në 21 - vjetorin e rënies heroike të dëshmorëve të kombit, Visar M. Hoti dhe Safet L. Latifi.

Lavdi jetës dhe veprës së tyre!

Vendosja e Tunelit Dezinfektues, në rrugën kryesore (te semaforat), si masë mbrojtëse shtesë për parandalimin e përhapjes së COVID-19. Ideja për vendosjen e këtij Tuneli Dezinfektues fillimisht është inicuar nga OJQ-“INICIATIVA POZITIVE” si dhe është përkrahur nga këta donatorë: “AEP”, “INICIATIVA POZITIVE”, “RAMA PRINT”, “Auto-Romanel SA” dhe “RAIL TRANS”.



Për të gjashtë herë radhazi, ka vazhduar dezinfektimi i institucioneve shëndetësore dhe publike, poashtu, për herë të tretë kemi bërë dezinfektimin e rrugëve dhe hapësirave publike në qytetin e Rahovecit si dhe rrugëve dhe hapësirave publike në fshatrat e Komunës së Rahovecit.



Drejtorja e Shërbimeve Publike, me angazhimin vullnetar të kompanisë “MENDI-P”, ka filluar eliminimin e deponisë legale të mbetjeve inerte, poashtu, edhe heqjen e deponisë ilegale të mbeturinave përgjatë rrugës në fshatin Drenoc, për të vazhduar ditëve në vazhdim edhe në pjesë të tjera, që të kemi një mjedis të pastër për të gjithë. Eliminimi i këtyre deponive të mbeturinave inerte është bërë dhe vitin e kaluar, porse fatkeqësisht, qytetarët e papërgjegjshëm ende vazhdojnë të hedhin mbeturina në vende të ndaluara, duke ndotur mjedisin tonë të përbashkët.



Kryetari, z.Smajl Latifi së bashku me Ministren në detyrë të Administrimit të Pushtetit Lokal, znj. Emilija Redžepi, nënshkruan marrëveshjen e bashkëpunimit për Grantin e Performancës që si komunë e kemi fituar si rezultat i angazhimit, përkushtimit dhe efikasitetit të ekzekutivit komunal në Rahovec për qeverisje të mirë e transparente. Granti në vlerë prej: 255.731€, do të përdoret për realizimin e projekteve kapitale për këtë vit, duke përfshirë ndërtimin e rrugëve si dhe rregullimin e përrrenjve.



Teqeja e Madhe e Halvetive, përkatësisht prijësi i saj Shejh Besim Shehu, ka dhuruar një Tunel Dezinfektues, i cili është vendosur në objektin e Komunës së Rahovecit, si masë mbrojtëse shtesë për parandalimin e përhapjes së COVID-19. Ky tunel ka sistem automatik (me sensor), i cili aktivizohet posa të kalohet nëpër të, dhe tani e tutje mund të shfrytëzohet nga të gjithë qytetarët, para se të marrin shërbimet e tyre pranë Administratës Komunale në Rahovec

Kryetari Latifi, ka pritur në takim Kryeministrin në detyrë, z. Albin Kurti si dhe Ministren në detyrë të Administrimit të Pushtetit Lokal, znj.Emilja Resdžepi, të cilët i njoftoi rreth gjendjes aktuale në komunën e Rahovecit si dhe për masat që kemi ndërmarrë në parandalimin e pandemisë COVID-19. Me z. Albin Kurti biseduan për shumë gjëra që po i preokupojnë rreth pandemisë COVID-19, poashtu , Kryetari Latifi i shprehu shqetësimet tona serioze si komunë, lidhur me masat kufizuese të cilat janë vendosur për bizneset tona në sektorin e ndërtimit dhe prodhimit, biznese këto me numrin më të madh të të punësuarve.



Vazhdojnë punimet për ndërtimin e shtegut të ecjes "LULET E MARSIT", në Krushë të Madhe. Shtegu do të jetë i gjatë 1050 metra dhe qytetarët e Krushës së Madhe mund ta shfrytëzojnë për ecje, vrapim apo qëndrim ditor

Në Drenoc, Kryetari Latifi me bashkëpunëtorë, familjarë dhe përfaqësues të OVL e UÇK-së, përkujtuan 26 Prillin 1998, Ditën e daljes publike të UÇK-së, e cila më pas u përhap si rrufeja në gjithë Anadrininë dhe Zonën Operative të Pashtrikut.

I paharruar përjetë është 26 Prilli 1998!

Lavdi!



Janë 1641 qytetarë të Kosovës për fatin e të cilëve ende nuk dihet! Ka edhe shumë të pagjetur nga komuna e Rahovecit, e në Krushë të Madhe, në kuadër të Ditës së të Zhdukurve të Kosovës, Kryetari Latifi me bashkëpunëtorë dhe përfaqësues të këshillit të fshatit Krushë e Madhe ndezën nga një pishtar për 64 të pagjeturit e këtij fshati që i dha shumë lirisë së Kosovës, duke përfshirë edhe atdhetarin e paepur Ukshin Hotin, i cili është ende i pagjetur!



Ndërtimin e parkut e përfunduam edhe në Celinë. Pranvera është stina kur njerëzit dalin nga shtëpitë për ta përjetuar mrekullinë e ringjalljes së natyrës, kështu që parqet e hapësirat e gjelbra janë gjithmonë të mirëseardhura.

Parku në Malësinë e Vogël e mori formën përfundimtare. Një vend publik më shumë për banorët e fshatit që ta kalojnë kohën e lirë nën rrezet e diellit e në ajrin e pastër. Urime banorëve, ta gëzojnë!



Me ballin drejt Pashtrikut, Kulla e dy heronjve të kombit, Toni e Mici, po merr formë. Lavdi e përjetshme dëshmorëve të kombit dhe UÇK-së!



Fermerëve të Malësisë së Vogël po i'u krijohet qasje më e lehtë dhe më e shpejtë në tokat e tyre të punës, me investimet e Komunës së Rahovecit në projektin e rregullimit të rrugëve fushore.

Fermerëve ju dëshirojmë punë të mbarë!



Janë duke vazhduar punimet në disa lokacione për rregullimin e infrastrukturës bujqësore, si: Ratkoc, Brestoc, Kaznik dhe Polluzhë.



Traseja e ndërtimit të rrugëve në Rahovec!
Njëri prej segmenteve të infrastrukturës rrugore në trekëndshin Xërxë-Sapniq-Ratkoc!

Rruga do të ketë edhe elementet përcjellëse, si; asfaltimi i rrugës, shtegu, trotuare dhe ndriçim publik



Drejtoria e Shërbimeve Publike, me angazhimin vullnetar të kompanisë "TEUTA-T" nga Rahoveci, ka rregulluar rrugën në drejtim të deponisë legale të mbetjeve inerte.

A photograph showing a construction worker in a trench. The worker is wearing a light blue long-sleeved shirt, dark pants, and a hard hat. They are standing next to a trencher, which is a machine used for cutting slots in the ground. The trencher has a large, rotating cutting wheel with multiple blades. The worker appears to be operating the machine, which is cutting a slot into the earth. The trench is deep and the soil is dark brown. The background shows more of the trench and some construction equipment.



Komuna e Rahovecit, në bashkëpunim me IADK-në ka mbështetur katër (4) fermerë të rikthyer, Ky aktivitet është bërë i mundur në kuadër të projektit “Përfshirja ekonomike e të riatdhesuarve përmes bujqësisë në zonat rurale dhe ngritja e kapaciteteve përmes trajnimit profesional”, i financuar nga Deutsche Gesellschaft für internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH, mandatuar nga Republika Federale e Gjermanisë.



**Vazhdojnë punimet në kanalin e
kullimit të tokave bujqësore në
Malësi të Vogël dhe Ratkoc**

[illegible]

"Përfshirja e fermerëve në Pakon Emergjente Fiskale"



Situata e krijuar pas shfaqjes së pandemisë COVID-19, ka krijuar vështirësi të mëdha për plasimin e produkteve bujqësore në treg, e jona është të sigurojmë qasjen e nevojshme për shitjen e këtyre produkteve, pra sigurimin e hapësirës për treg.

Kemi investuar vazhdueshëm dhe tani kemi hapësirë shumë të përshtatshme për produktet e fermerëve tanë! Po punojmë nga afër me organet kompetente të nivelit qendror dhe jemi në pritje të përgjigjes për hapjen e tregut. Ne jemi gati për hapje të tregut!

Drejtoresha e DKRS-së, znjsh. Bjondina Kleqka ka mbajtur takim me kryesinë e KF Rahoveci në mjediset e bibliotekës komunale "Sulejman Krasniqi", ku u diskutua gjendja në këtë klub në kohën e krizës globale të pandemisë COVID-19.



Me të marrë lajmin se një objekti afarist/banesor si dhe dy trafika të cilat gjenden në qytetin e Rahovecit janë përfshirë nga zjarri, ekipi i zjarrfikësve tanë ka dalë menjëherë në vendet e ngjarjes për të intervenuar. Drejtori i DMSH-së, z.Hasan Përboqi ka bërë të ditur se fatmirësisht nuk kemi të lënduar, ka vetëm dëme materiale, zjarri është lokalizuar dhe është shuar tërësisht.



PËRFUNDIM

Ky buletin përmbledhës paraqet thekset kryesore të aktiviteteve që kanë ndodhur gjatë kësaj periudhe: (prill 2020).

Edhe pse fusha e qeverisjes së mirë është mjaft e gjerë, një aspekt i rëndësishëm i saj që është i pashmangshëm për ta plasuar qytetarin në vend qendror është liria e informimit. Informacioni është themeli i qeverisjes së mirë, jo vetëm sepse e rrit efikasitetin por gjithashtu sepse i fuqizon qytetarët dhe mundëson shpërndarje të barabartë të përfitimeve nga zhvillimi i përgjithshëm në vend, andaj duke dashur që të jetë sa më transparente me publikun, Komuna e Rahovecit përmes këtij dokumenti ka ofruar një pasqyrë të përgjithshme të aktiviteteve të saj, për t'iu dhënë mundësi qytetarëve që të njohin e vlerësojnë punën e institucioneve komunale.

Komuna e Rahovecit ka vënë në funksion këto parime përmes formave të ndryshme të komunikimit me qytetarë, takimeve të drejtpërdrejta, informimit publik dhe çfarëdo metode tjetër përmes së cilës transparenca të ndikojë në avancimin e vetëqeverisjes lokale.

Përveç konsultimit dhe komunikimit, këto dokumente forcojnë lidhjet e qytetarëve me komunën dhe rrisin besimin që e gëzojnë zyrtarët publik në nivel lokal.

Vërejtje: Lista e vendimeve të marra nga ana e Kryetarit të Komunës, do të publikohet veçmas ditët në vijim, poashtu edhe lista me donatorët të cilët kanë ndihmuar familjet në nevojë të komunës së Rahovecit, pas shfaqjes së pandemisë COVID-19, do të publikohet në informatën shtesë lidhur me masat e ndërmarra nga ana e Shtabit të Posaçëm Emergjent në Komunën e Rahovecit për parandalimin e përhapjes së infeksionit COVID-19.

Rahovec, 5 maj 2020